| A1 | Blerje + instalim, sistem përsëritës, përforcues të sinjalit të radiove të dorës për policinë bashkiake (repetitor, radio bazë, antene,aksesor të plotesues, në valën UHF/VHF) | 300 | | | 300 |
| A.2 | Shërbim telefonik per nevojat e drejtorise | **20** | | 20 | |
| | **Shuma** | **320** | | **20** | 300 |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga, sigurime | Operative | Kapitale |
| A.1 | Mirëmbajtje të sistem përsëritës, përforcues të sinjalit të radiove të dorës për policinë bashkiake (repitor, radio bazë, aksesor të ndryshëm në valën UHF/VHF) | **80** | | 80 | |
| A.2 | Sherbim telefonik per nevojat e drejtorise | **20** | | 20 | |
| | **Shuma** | **100** | | **100** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga, sigurime | Operative | Kapitale |
| A.1 | Mirëmbajtje të sistem përsëritës, përforcues të sinjalit të radiove të dorës për policinë bashkiake (repitior, radio bazë, aksesor të ndryshëm në valën UHF/VHF) | **80** | | 80 | |
| A.2 | Shërbim telefonik për nevojat e drejtorisë së Policisë Bashkiake | **20** | | 20 | |
| | **Shuma** | **100** | | **100** | |

| **f)Periudha e zbatimit**<br><br>2026-2028 | **g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Policia Bashkiake**Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër |
|---|---|

| Nr. 4 | **P.AB141.Q1.O1.A4**<br>Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policisë Bashkiake | **Programi AB141**: Siguria publike dhe Mbrojtja civile |
|---|---|---|

**Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Në funksion të Policisë Bashkiake janë 8 automjete nga të cilat:1 automjet Land Rover dhe 1 automjet karrotrec ,3 janë të dhuruara, të amortizuara, 3 janë të reja automjete elektrike. Automjetet kanë nevojë në vazhdimësi për shërbime mirëmbajtje, furnizim me karburant, shërbimin e kontrollit teknik, pagesën e taksave dhe siguracioneve gjatë vitit, larje e pastrim. Per shkak te rritjes se ngarkeses ne pune, ne drejtim te qarkullimit rrugor, te kontrollit te territorit, shtimit te punës në pikat turistike ka lindur domosdoshmëria e shtimit dhe mbajtjes në efiçiencë të automjeteve për trupat e shërbimit si dhe marrjen e automjeteve të reja elektrike realizohet në vitin 2026

**ii. Synimi i projektit**

Mjete transporti funksionale, për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të Policisë Bashkiake sipas nevojave që ato kanë.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Vlerësimi i gjendjes teknike të mjeteve të transportit në serviset e liçensuara dhe përcaktimi i mjeteve që duhet të riparohen dhe të kthehen apo të mbahen në gjendje pune, si dhe përcaktimi i mjeteve që duhet të nxirren jashtë përdorimit nga komisioni (proces në vazhdim).
2. Identifikimi i nevojave për karburant, pjesë këmbimi dhe shërbimi i mirëmbajtjes së këtyre automjeteve.
3. Përgatitja e preventivave dhe dokumentacio neve përkatëse të nevojshme për prokurim.
4. Zbatimi i procedurave të prokurimit sipas specifikimeve teknike të paracaktuara dhe monitorimi.

4.1. Blerje karburanti për nevojat e Policisë Bashkiake Shkodër
4.2. Shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit
4.3. Siguracioni i automjeteve
4.4. Taksa qarkullimi, kolaudimi
5. Marrja në dorëzim dhe magazinimi i mallrave apo shërbimeve

**b) Rezultatet e pritshme**

Mjete transporti në gjendje pune në gadishmëri më të lartë për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme tëpolicisë vendore të Bashkisë Shkodër sipas nevojave.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme** |
|---|---|
| Policia Bashkiake<br>Drejtoria e Shërbimit dhe Infrastrukturës Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet sipas aktiviteteve 2026** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo : | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga,sigurime | Operative | Kapitale |
| A.1 | Blerje karburanti për nevojat e Policisë Bashkiake Shkodër | **1,500** | | 1,500 | |
| A. 2 | Shërbim mirëmbajtje për mjetet e transportit, sherbime te tjera (larje automjetit, GBS) | **1,500** | | 1,500 | |
| A. 3 | Siguracioni i automjeteve | **500** | | 500 | |
| A. 4 | Pagesa e taksave të qarkullimit dhe kolaudimi i automjeteve | **400** | | 400 | |
| A5. | Blerje automjetesh | **12,000** | | | 12,000 |
| A.6 | Pajisje me sinjalistike zanore dhe optike per makinat e Policise Bashkiake | **200** | | 200 | |
| **Shuma** | | **16,100** | | **4,100** | 12,000 |

| **Shpenzimet sipas aktiviteteve 2027** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo : | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga,sigurime | Operative | Kapitale |
| A.1 | Blerje karburanti për nevojat e Policisë Bashkiake Shkodër | **1,500** | | 1,500 | |
| A. 2 | Shërbim mirëmbajtje për mjeteve të transportit,sherbime te tjera(larje automjetit,GBS) | **1,500** | | 1,500 | |
| A. 3 | Siguracioni i automjeteve | **500** | | 500 | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| A. 4 | Pagesa e taksave të qarkullimit dhe kolaudimi i automjeteve | **400** | | 400 | |
| **Shuma** | | **3,900** | | **3,900** | |
| **Shpenzimet sipas aktiviteteve 2028** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo : | | |
| | | | Paga.sigurime | Operative | Kapitale |
| A.1 | Blerje karburanti për nevojat e Policisë Bashkiake Shkodër | **1,500** | | 1,500 | |
| A. 2 | Shërbim mirëmbajtje për mjeteve të transportit,sherbime te tjera(larje automjetit) | **1,500** | | 1,500 | |
| A. 3 | Siguracioni i automjeteve | **500** | | 500 | |
| A. 4 | Pagesa e taksave të qarkullimit dhe kolaudimi i automjeteve | **400** | | 400 | |
| **Shuma** | | **3,900** | | **3,900** | |
| **f)Periudha e zbatimit**<br><br>2026-2028 | | **g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Policia Bashkiake<br><br>**Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër | | | |

| **Nr.5** | **P.AB141.Q1.O1.A5**<br>Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policisë bashkiake | **Programi AB141**: Siguria publike dhe Mbrojtja civile |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Sasia e shtypshkrimeve duhet të plotësohet çdo vit sipas nevojave të Policisë Bashkiake. Mungesa në materiale sjell pasoja në përmbushjen e detyrave dhe kërkon vazhdimisht planifikim shpenzimi për blerjet e dokumentacioneve të domosdoshme e për kryerjen dhe ofrimin e shërbimeve. Rritja e kërkesës për blerje të dokumentacionit (shtypshkrime të ndryshme, akt konstatimi, blloqe gjoba, liber shërbime etj) është domosdoshmëri për mbarëvajtjen e punës së Policisë Bashkiake në Bashkinë Shkodër dhe kërkohet sigurimi I dokumentacionit për: blloqe gjoba dhe blloqe akt konstatimi, blloqe për akte të tjera
administrative në rastet e automjeteve që do të zhvendosen, libra sherbimit etj..

**ii. Synimi i projektit**

Të rritet performanca në punë e Policisë Bashkiake të Bashkisë. Sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me shtypshkrime, që t'iu mundësojë punonjësve përmbushjen e detyrave dhe objektivave.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Identifikimi i kërkesës për materiale
2. Vlerësimi i kërkesave në përputhje me kapacitetet
3. Zbatimi procedurave tenderuese

3.1 Blerje dokumentacione (shtypshkrime)

3.2 Marrja në dorëzim dhe magazinimi i materialeve

4. Shpërndarja sipas planit të aktiviteteve të projektit
5. Sigurimi dhe furnizimi sipas kërkesave

**b) Rezultatet e pritshme**

- Përmirësim i kushteve të punës dhe përmbushja e detyrave në kohë për policine bashkiake të Bashkisë Shkodër
- Rritja e eficensës dhe efektivitetit në punë nëpërmjet sigurimit të shërbimeve bazë siç është furnizim i vazhdueshëm me shtypshkrime për punonjësit.
- Rritjen e performancës dhe përmirësimin e cilësisë së punës në shërbim të komunitetit.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër | Bashkia e Shkodrës |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga, sig | Operative | Kapitale |
| A.1 | Blerje dokumentacione (shtypshkrime) | **1,500** | | 1,500 | |
| **Shuma** | | **1,500** | | **1,500** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga, sig | Operative | Kapitale |
| A.1 | Blerje dokumentacione (shtypshkrime) | **1,500** | | 1,500 | |
| **Shuma** | | **1,500** | | **1,500** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga, sig | Operative | Kapitale |
| A.1 | Blerje dokumentacione (shtypshkrime) | **1,500** | | 1,500 | |
| **Shuma** | | **1,500** | | **1,500** | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| 2026-2028 | Policia Bashkiake<br><br>**Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër |

| Nr.6 | **P.AB141.Q1.O1.A6**<br>Kamera sigurie (CCTV) për ambiente publike dhe mirëmbajtja e tyre. | **Programi AB141: Siguria publike dhe Mbrojtja civile** |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Bazuar në nenin 29 të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike, Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e mbrojtjes civile, në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
Në nenin 5 të ligjit Nr.19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike", përcaktohen qartë detyrimet në funksion të përcaktimeve ligjore, kërkohet marrja e masave shtesë per sigurinë në sheshe të hapura, parqe, kënde të lojërave, parkime, në mjedise të hapura apo të mbyllura, që kemi në administrim apo pronësi dhe që sipas vlerësimit të Policisë Bashkiake përbëjnë burim rreziku të shtuar për rendin dhe sigurinë publike.
Policia e Shtetit identifikon të gjitha subjektet që disponojnë dhe administrojnë sisteme të sigurisë, si kamera për regjistrim të pamjeve filmike, CCTV me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NRV/Server deri në 2 muaj apo përdorin pajisje elektronike të teknologjisë së lartë për identifikimin, në funksion të sigurisë (detektorë, ura kontrolli, reader, GPS etj.), me qëllim njoftimin dhe regjistrimin e tyre në regjistrin e të dhënave.
Masat shtesë të sigurisë janë:

- Përdorimi i sistemit të kamerave CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe, që ruajnë imazhet filmike në NRV/Server deri në 2 muaj;
- Përdorimi i pajisjeve elektronike të teknologjisë së lartë për identifikimin, në funksion të sigurisë (detektorë, ura kontrolli, reader, GPS etj.);
- Në varësi të vlerësimit të rrezikut dhe në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, lidhja e sinjalit të alarmit për bankat dhe objekte të rëndësishme shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, me sallat e komandimit/informacionit të Policisë së Shtetit;
- Përdorimi i Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike (SHPSF).
- Niveli i masave shtesë të sigurisë dhe lloji i masës që duhet të përdorin subjektet, në varësi të aktivitetit apo vlerësimit të rrezikut, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
- Vendosja dhe përdorimi i masave shtesë të sigurisë shoqërohet me njoftimin për publikun.

Bashkia me nismën e saj, me burimet e veta financiare ka investuar për blerjen dhe instalimin e kamerave me rezolucion të lartë me qëllim ngritjen në nivel më të lartë të shërbimit të sigurisë dhe qetësisë publike në interes të bashkësisë.
Bashkëpunimi me drejtorinë vendore të Policisë së Qarkut Shkodër, Ministrinë e Brendshme është e domosdoshme. Mirembajtja e instrumentave të tillë për rritjen e kontrollit dhe monitorimit të sigurisë publike do të ndihmojë dhe mbështesë edhe punën e Drejtorisë Vendore të Policisë, institucioneve të tjera publike, bizneseve dhe familjeve në Shkodër. Do të garantojë më shumë siguri dhe rend për rininë dhe do të ndihmojë në reduktimin e kundravajtjeve dhe krimit.
Të jenë prioritet

- Kamera sigurie (CCTV) për ambjente publike dhe mirëmbajtja e tyre, vendosja e kamerave ose edhe rritja e masave monitoruese në rrugën drejt malësive të Dukagjinit, Cukalit për të mbikëqyrur prerjen dhe transportin e paligjshëm të pyjeve, aktivitete të tjera të paligjshme.
- Të forcohen masat monitoruese në sheshin, parkingjet e Shirokës, kjo zonë duhet të ketë përparësi në vendosjen e kamerave.
- Të shtohen kamerat monitoruese në kryqëzimin e rrugës "Bujar Bishanaku" me rrugën "Nazmi Kryeziu", me qëllim monitorim trafikut dhe hapësirave publike në këtë rrugë.
- Të shtohen kamerat monitoruese në kryqëzimin e rrugëve "Te Plepi", me qëllim monitorim trafikut dhe hapësirave publike në këtë rrugë.
- Të vendosen kamerat monitoruese në sheshin kryesor Velipojë si dhe përgjatë pedonales së plazhit, me qëllim monitorim hapësirave publike dhe rritjen e sigurisë për turistët.
- Të shqyrtohet mundësia, në bazë të vlerësimit të kostos financiare, për bashkërendimin e investimit në fibrat optike të rrjetit të kamerave të sigurisë për t'u integuar me sistemin e Policisë së Shtetit.

Të përfshihet përshkrimi dhe raportimi i punës të këshillit të sigurisë në këtë projekt:

**ii. Synimi i projektit**

- Mirëmbajtje e qendrueshmër e sistemit të vëzhgimit me kamera (CCTV) dhe rritja e numrit të tyre me qëllim mbikqyrjen e ambienteve publike, në të cilin mund të zhvillohen veprimtari të ndryshme ekonomike, tregtare, sportive, kulturore, mjedise publike e private për shërbime, parkim automjetesh, me qëllim rritjen e sigurisë publike.
- Rritjen e sigurisë dhe qetësisë publike.
- Sigurimin e monitorimit dhe kontrollit më të mirë të territorit duke investuar në blerjen dhe instalimin e rreth 20 kamerave rezolucion të lartë me qëllim ngritjen në nivel më të lartë të shërbimit të sigurisë dhe qetësisë publike në interes të bashkësisë.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Procedurat për verifikimin e nevojave për shërbim
- Përgatitja e specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime;
- Realizimi i procedurave të prokurimit;
- Njoftimi për publikun

**b) Rezultatet që prisni**

- Mbajtja e sistemit të kamerave në gjendje optimale në shërbim të rritjes së sigurisë publike;
- Rritja e sigurisë publike
- Rritja e kapaciteteve monitoruese të pikave të cilat sipas analizës së rriskut rezultojnë me fluks të shtuar të mundësive për ndodhi ose ngjarje që cënojnë rendin dhe sigurinë publike;
- Reduktim i kundravajtjeve administrative;
- Reduktim i veprave penale;

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| **Policia Bashkiake Policia e Shtetit** | **Bashkia e Shkodrës** |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 1 | Mirëmbajtja e sistemit të kamera sigurie | 2,000 | | | 2,000 | | |
| A. 2 | Furnizim vendosje kamera sigurie per ambiente publike. | 1,500 | | | | | 1,500 |
| | **Shuma** | **3,500** | | | **2,000** | | 1,500 |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 1 | Mirëmbajtja e sistemit të kamera sigurie | **2,000** | | | **2,000** | | |
| | **Shuma** | **2,000** | | | **2,000** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 1 | Mirëmbajtja e sistemit të kamera sigurie | **2,000** | | | **2,000** | | |
| | **Shuma** | **2,000** | | | **2,000** | | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| 2026-2028 | Policia bashkiake<br>**Institucioni likuidues**:Bashkia Shkodër |

| Nr.7 | **P.AB141.Q2.O1.A1.** Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër. Burimet e veta | **Programi AB141:** Siguria publike dhe Mbrojtja civile |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Baza ligjore:139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 29, LIGJ Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM nr 965 date 02.12.2015 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e Emergjencave Civile dhe krizave",ligji 45/2019 "Për mbrojtjen civile", shkresa nr.2634/2 datë13.12.2019 e Ministrisë së Mbrojtjes "Mbi zbatimin e dispozitave tëligjit nr.45/2019 "Për Mbrojtjen civile.

Shërbimi për mirëmbajtjen emergjente të akseve të rrugëve ka pasur një rol të rëndësishëm në menaxhimin e kushteve të dimrit gjatë periudhës së reshjeve të dëborës, si në zonat malore, ashtu edhe në ato fushore. Nga operatori i kontraktuar janë realizuar masa të përshtatshme për të garantuar kalueshmërinë e akseve të rrugëve dhe për të përballuar izolimet e mundshme që mund të shkaktohen nga dëbora, veçanërisht në zonat malore.
Për të siguruar një nivel të lartë të gatishmërisë, janë bërë përgatitje përmes blerjeve të 80 ton kripë të zezë, e cila është përdorur për të mbajtur të hapura rrugët rurale dhe urbane dhe për të parandaluar formimin e ngricave. Kjo ka ndihmuar në rritjen e sigurisë për qytetarët që udhëtojnë gjatë periudhave të dimrit.

Po ashtu, për të përmirësuar menaxhimin e situatave emergjente në të ardhmen, është duke u realizuar një procedurë për marrëveshje kuadër, me objekt "Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të qytetit dhe të Njësive Administrative (zonat fushore)". Ky marrëveshje ka për qëllim përforcimin e gatishmërisë për mirëmbajtjen e akseve të rrugëve në zonat urbane dhe fushore, duke parashikuar masa të mëtejshme për të përballuar sfidat e mundshme që mund të krijohen nga kushtet klimatike të dimrit.

Këto përpjekje janë një pjesë e angazhimit për përmirësimin e sigurisë dhe menaxhimit të infrastrukturës rrugore, duke garantuar kalueshmërinë dhe mbrojtjen e qytetarëve gjatë dimrit.
**-**Vënie në shërbim i dy borëpastruese për hapje rruge, në zonat fushore.
Këto mjete të specializuara janë parashikuar të ndërhyjnë në rrugët e qytetit dhe të njësitë administrative fushore, për të bërë të mundur pastrimin e borës në mënyrë që të sigurohen kushtet e qarkullimit në një kohë sa më të shpejtë të njerëzve dhe mjeteve.
**-** Vënie në shërbimi një fadromë për punime hapje rruge në raste emergjencash, në zonat malore.
**-** Vënie në shërbim i dy eskavatorëve për punime hapje rruge në raste emergjencash, në zonat malore

Me këto 3 mjete janë parashikuar ndërhyrjet për hapjen e rrugëve në aksin Ura e Mesit-Prekal – Kir –Mali Shoshit –Breglumi- Ndërlysaj-Thethë, njësia administrative Postribë-Pult –Shosh-Shalë. Punimet e parashikuara janë zhbllokimi i rrugëve nga dëbora në të gjithë aksin si dhe hapjen e rrugëve dhe riparimin e pasojave nga rreshqitjet e materialeve si gurë, dhera etj.
Me këto masa i kemi paraprirë ndërhyrjeve në kohë për hapjen e rrugëve për të bërë të mundur zvogëlimin e kohës së izolimit për banorët e këtyre zonave.
Rruga Qafë Thore-Theth është në administrim të subjektit sipërmarrës të kontratës së shërbimit që karealizuar investimin me fonde të FSHZH-së.

Problemet e paraqitura:
- Pamjaftueshmëria e mjeteve për përballimin e situatave që krijohen nga emergjencat civile
- Nevoja për plotësim i strukturës së emergjencave civile sipas parashikimeve ligjore.
- Mungesa e kapaciteteve për përballimin e situatës në rast të përmbytjeve në Njësitë Administrative që preken nga përmbytjet.

**ii. Synimi i projektit**

Duke iu referuar
- Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile",

Synojmë:
- Sigurimi i një mbrojtjeje efektive dhe të qëndrueshme për qytetarët dhe asetet e Bashkisë Shkodër nga fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile.
- Krijimi dhe organizimi i një strukture të dedikuar për menaxhimin e emergjencave civile në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Angazhimi i vullnetarëve civilë si pjesë integrale e këtyre strukturave, duke kontribuar në reagimin e shpejtë dhe efektiv ndaj situatave emergjente
- Puna për të ulur rrezikun dhe ndikimin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera, me qëllim realizimin e mbrojtjes civile në nivelin më të lartë të mundshëm.
- Sigurimi i informacionit të vazhdueshëm dhe të qartë për qytetarët në lidhje me rreziqet dhe aktivitete emergjente, për të mundësuar veprime parandaluese.
- Prioriteti është parandalimi i situatave që mund të rrezikojnë jetën dhe pronën e qytetarëve, bizneseve, pasurive kulturore, natyrore dhe aseteve të tjera administrative.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Vlerësimi i disponibilitetit të burimeve njerëzore për përfshirjen e tyre në planikimin dhe menaxhimin e EC.
- Mbledhja e të dhënave nga të gjitha kompanitë private për mjetet që perdoren nga ana e tyre dhe që mund të angazhohen në rast të EC.
- Masat paraprake për përballimin e situatave nga rreshjet.
- Përmirësimi i kapaciteteve teknike nëpërmjet realizimit të blerjes së mjeteve për përballimin situate të EC.
- Trajnim i stafit të strukturave të bashkisë.

- Mledhja e të dhënave për të gjithë personat, institucionet, ojf etj. që kanë rol në planikimin dhe menaxhimin e EC.
- Hartimi i skemës së lajmërimit.
- Grumbullimi i të gjithe dokumentacionit ekzistues për vlerësimin e riskut në territor.
- Përgatitja e hartave të rrezikut për territoret që mungojnë.
- Takime në çdo NJA, rajon, lagje me perfaqësues komuniteti e struktura për hartimin e planit të masave që merren në rast rreziku.
- Vendosja e elementeve të sigurisë në institucionet publike si: shkalla e emergjencës, fikëset e zjarrit , hidrantët,etj.
- Sistemimi i kanaleve shkarkuese që rrezikojne të sjellin gjendjen e EC.
- Sistemimi i rrugeve kryesore që mund të bllokohen nga dëbora.

Për vitin 2026 - 2028 shpenzimet parashikohen si më poshtë:

| Llogaritja e fondit te mbrojtjes civile | | | |
|---|---|---|---|
| **VITI** | **2026** | **2027** | **2028** |
| **Burimet e veta** | **3,236,383** | **3,311,791** | **3,322,020** |
| **Fondet tona 1 %** | 32,363 | 33,117 | 33,220 |
| **Fonde te planifikuara** | **32,363** | **33,117** | **33,220** |

**b) Rezultatet që prisni**

Bashkia Shkodër përballon në mënyrë optimale situatat e emergjencave civile (ka kontroll mbi territorin, ka plan emergjence masash, shërben duke iu përgjigjur nevojës emergjente)

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| Bashkia Shkodër | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2026 | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: Paga | Sig uri me | Oper ative | Transf erta | Kapi tale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile | **32,363** | | | | 32,363 | |
| **Shuma 2026** | | **32,363** | | | | 32,363 | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: Paga | Sig uri me | Oper ative | Transf erta | Kapi tale |
| A.1 | Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile | **33,117** | | | | 33,117 | |
| **Shuma 2027** | | **33,117** | | | | **33,117** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: Paga | Sig uri me | Oper ative | Transf erta | Kapi tale |
| A.1 | Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile | **33,220** | | | | 33,220 | |
| **Shuma 2028** | | **33,220** | | | | **33,220** | |

| f) Periudha e zbatimit 2026 – 2028 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Personeli i Drejtorisë së Emergjencave Civile ne Bashki<br>**Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër |
|---|---|

| Nr.8 | **P.AB141.Q2.O1.A2.**<br>Mjete funksionale për operacione, mbikëqyrje, monitorim dhe parandalim të emergjencave civile | **Programi AB141:** Siguria publike dhe Mbrojtja civile |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

i. Situata

- **Mjete funksionale për operacione, mbikëqyrje, monitorim dhe parandalim të emergjencave civile**

Drejtoria e Emergjencave Civile në Bashkinë Shkodër ka një rol thelbësor në menaxhimin, koordinimin dhe ndërhyrjen në situata të emergjencave natyrore dhe atyre të shkaktuara nga faktori njerëzor. Aktualisht, kjo drejtori nuk disponon mjete transporti, gjë që e kufizon ndjeshëm kapacitetin operacional për të përballuar ndërhyrjet në terren, veçanërisht në raste përmbytjesh, rrëshqitjesh dherash, zjarresh, situatash me rrezikshmëri të lartë si dhe në monitorimin e vazhdueshëm të zonave të riskut. Për këtë arsye, është e nevojshme pajisja me mjete të përshtatshme transporti që mundësojnë reagim të shpejtë, të sigurt dhe efikas në çdo situatë emergjente.

Mungesa e mjeteve funksionale kufizon ndjeshëm:

- Mobilizimin e shpejtë të ekipeve operacionale;
- Monitorimin e vazhdueshëm të zonave të cenueshme;
- Koordinimin në terren me strukturat e tjera;
- Transportin e pajisjeve dhe personelit teknik;
- Parandalimin dhe reagimin e shpejtë ndaj emergjencave.

Për të garantuar efikasitet dhe veprim në kohë reale, është e domosdoshme blerja e mjeteve të reja funksionale (automjete operacionale 4x4), të përshatshme për terrene të vështira dhe për ndërhyrje emergjente.

**ii. Synimi i projektit**

Synimi i projektit është të sigurojë mjete transporti moderne dhe funksionale për Drejtorinë e Emergjencave Civile, me qëllim rritjen e kapaciteteve operative, monitoruese dhe parandaluese në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.
Projekti synon:

- Rritjen e reagimit të shpejtë dhe të koordinuar në situata emergjence;
- Përmirësimin e monitorimit të zonave të riskut;
- Sigurimin e mjeteve të nevojshme për transportin e personelit dhe pajisjeve;

Forcimin e kapaciteteve të njësisë për të përmbushur funksionet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore mbi menaxhimin e emergjencave civile.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Vlerësimi teknik i nevojave për mjete transporti nga Drejtoria e Emergjencave Civile
Prokurimi i mjeteve funksionale (automjete 4x4 për terrene të vështira)
Marrja në dorëzim dhe regjistrimi i mjeteve
Trajnimi i stafit për përdorimin dhe mirëmbajtjen
Vënia në përdorim të mjeteve për operacione, monitorim dhe parandalim

**b) Rezultatete pritshme**

Rritje e efikasitetit operativ të Drejtorisë së Emergjencave Civile në menaxhimin dhe parandalimin e situatave emergjente.
Përmirësim i reagimit në kohë reale ndaj ngjarjeve të papritura, duke ulur rrezikun për popullatën dhe infrastrukturën. Rritje e mbikëqyrjes dhe monitorimit të zonave me risk të lartë në territorin e Bashkisë Shkodër.
Përmirësim i koordinimit ndërinstitucional në situata emergjente.
Siguri më e lartë për personelin, pajisjet dhe komunitetin.

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| 1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse<br>2. Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Shkodër | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2026** | | Total (000 lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferta | Kapitale |
| A.1. | Blerja e mjeteve funksionale (automjete 4x4) | **7,800** | | | | | 7,800 |
| **TOTALI 2026** | | **7,800** | | | | | 7,800 |

| f) Periudha e zbatimit 2026 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Personeli i Drejtorisë së Emergjencave Civile ne Bashki<br>**Institucioni likuidues**: Bashkia Shkodër |
|---|---|

| Nr.9 | **P.AB141.Q2.O1.A3.**<br>Pajisje dhe veshje pune për emergjenca civile | **Programi AB141:** Siguria publike dhe Mbrojtja civile |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

i. Situata

- **Pajisje dhe veshje pune për emergjenca civile**

Drejtoria e Emergjencave Civile e Bashkisë Shkodër ka detyrën e reagimit dhe menaxhimit të situatave të emergjencës, duke kryer monitorim, mbikëqyrje dhe operacione në terren. Aktualisht, njësia operacionale përballet me mungesë të pajisjeve thelbësore dhe mjeteve bazike të sigurisë, të nevojshme për ndërhyrje të shpejtë dhe efektive në raste përmbytjesh, zjarresh, rrëshqitjesh dherash dhe emergjencave të tjera natyrore apo të krijuara nga faktori njerëzor.

Mospasja e një inventari të plotë të pajisjeve rrit rrezikun për personelin, ul efikasitetin operativ dhe dëmton cilësinë e ndërhyrjes. Për këtë arsye, është e domosdoshme furnizimi i sektorit me pajisje mbrojtëse, mjete ndriçimi, mjete pune, pajisje sinjalizuese dhe elemente të tjera të domosdoshme për operacione emergjente.
Lista e pajisjeve të nevojshme për përmirësimin e kapaciteteve operacionale përfshin:
Çadra për emergjenca, Kone sinjalizimi , Shirita sigurie, Pompa shpine kundër zjarrit, Metër lazer Bosch, ,Adesiva me numrin e emergjencave, dhe paisje te tjera te ngjashme.
Këto pajisje plotësojnë standardet minimale të nevojshme për ndërhyrje në terren, sigurojnë mbrojtje individuale dhe rrisin efikasitetin në operacionet e emergjencave.

**ii. Synimi i projektit**

Synimi kryesor i projektit është furnizimi i Drejtorisë së Emergjencave Civile me pajisjet dhe veshjet e nevojshme të punës, për garantimin e një niveli të lartë sigurie, gatishmërie dhe reagimi operacional.
Projekti ka për objektiv:
-Rritjen e sigurisë dhe mbrojtjes së stafit gjatë operacioneve;
-Përmirësimin e aftësisë së reagimit të shpejtë;
-Sigurimin e pajisjeve standarde për ndërhyrje në terren;
-Rritjen e profesionalizmit dhe efikasitetit të njësisë;
-Përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore për emergjencat civile.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Identifikimi i nevojave dhe hartimi i specifikimeve teknike të pajisjeve;
Procedurat e prokurimit të pajisjeve dhe veshjeve të punës;
Marrja në dorëzim dhe regjistrimi në inventar i pajisjeve;
Shpërndarja e pajisjeve tek stafi operacionale;
Trajnimi dhe instruktimi për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve.

**b) Rezultatete pritshme**

• Sigurimi i një niveli të lartë mbrojtjeje dhe sigurisë për stafin e emergjencave.
• Rritje e efikasitetit dhe gatishmërisë së reagimit në situata emergjente.
• Pajisje të standardizuara dhe të përshtatshme për operacione të ndryshme në terren.
• Ulje e rreziqeve për dëmtime dhe aksidente gjatë ndërhyrjeve.
• Përmirësim i koordinimit dhe fleksibilitetit operativ të njësisë.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| 3. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse<br>4. Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Shkodër | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2026** | | Total (000 lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferta | Kapitale |
| A.1. | Pajisje dhe veshje pune për emergjenca | **500** | | | 500 | | |
| **TOTALI 2026** | | **500** | | | 500 | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2027** | | Total (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferta | Kapitale |
| A.1 | Pajisje dhe veshje pune për emergjenca | **500** | | | 500 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **TOTALI 2027** | | **500** | | | 500 | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2028** | | Total (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operativ e | Transfert a | Kapital e |
| A.1 | Pajisje dhe veshje pune për emergjenca | **500** | | | 500 | | |
| **Totali 2028** | | **500** | | | 500 | | |
| **f) Periudha e zbatimit** 2026 -2028 | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse **Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër | | | | | |

| Nr.10 | **P.AB141.Q2.O1.A4.**<br>Furnizim me karburant në funksion të emergjencave civile | **Programi AB141:** Siguria publike dhe Mbrojtja civile |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

i. Situata

Baza ligjore:139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 29, LIGJ Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM nr 965 date 02.12.2015 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e Emergjencave Civile dhe krizave",ligji 45/2019 "Për mbrojtjen civile", shkresa nr.2634/2 datë13.12.2019 e Ministrisë së Mbrojtjes "Mbi zbatimin e dispozitave tëligjit nr.45/2019 "Për Mbrojtjen civile".

Në kuadër të thirrjes së shpallur nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) për paraqitjen e projekteve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në fushën e Mbrojtjes Civile, Bashkia Shkodër synon të aplikojë me disa projekte për ndërtimin e urave të tipit "Bailey", të cilat do të realizohen në bashkëpunim me Repartin Ushtarak nr. 4040 (Batalioni i Xhenios).
Bazuar në praktikat e mëparshme, Bashkia do të marrë përsipër bashkëfinancimin e projekteve, përfshirë furnizimin me karburant të mjeteve të ushtrisë të angazhuara në këto operacione, si dhe ndërhyrje në raste të tjera emergjente sipas nevojave të Drejtorisë, që përfshijnë inspektim, mbikëqyrje dhe monitorim të infrastrukturës kritike dhe veprime të tjera mbështetëse në funksion të mbrojtjes civile.

**i. Synimi i projektit**

Duke iu referuar
- Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", Synojmë:
- Sigurimi i një mbrojtjeje efektive dhe të qëndrueshme për qytetarët dhe asetet e Bashkisë Shkodër ndaj fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile.
- Krijimi dhe organizimi i një strukture funksionale për menaxhimin e emergjencave civile, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Angazhimi i vullnetarëve civilë si pjesë e mekanizmave të reagimit në situata emergjente.
- Zvogëlimi i rrezikut dhe ndikimit të fatkeqësive përmes masave parandaluese dhe ndërhyrjeve të shpejta.
- Sigurimi i informimit të vazhdueshëm dhe të qartë për qytetarët në lidhje me rreziqet dhe veprimet që duhet të ndërmerren në raste emergjente.
- Parandalimi i situatave që mund të rrezikojnë jetën, pronën e qytetarëve, pasuritë kulturore, natyrore dhe asetet e tjera të Bashkisë.
- Përmirësimin e kapaciteteve të Bashkisë për inspektimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e infrastrukturës kritike, në mënyrë që të garantohet reagim i koordinuar dhe parandalim i situatave që mund të rrezikojnë jetën, pronën dhe pasuritë publike.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**
- Përmirësimin e kapaciteteve të Bashkisë për inspektimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e infrastrukturës kritike, në mënyrë që të garantohet reagim i koordinuar dhe parandalim i situatave që mund të rrezikojnë jetën, pronën dhe pasuritë publike.
- Zbatimi i ndërhyrjeve emergjente dhe operacioneve të kontrollit teknik, sipas kërkesave të Drejtorisë së Mbrojtjes Civile, përfshirë inspektim, mbikëqyrje dhe monitorim të infrastrukturës rrugore dhe urave, me qëllim garantimin e funksionalitetit dhe sigurisë së tyre.
- Forcimi i infrastrukturës mbështetëse për banorët e zonave rurale, duke siguruar lëvizshmëri të qëndrueshme dhe reagim të shpejtë në raste emergjente.
- Krijimi i një rrjeti efikas të shërbimeve emergjente, që mund të veprojnë pa pengesa në të gjitha zonat e Bashkisë Shkodër, veçanërisht në ato me akses të vështirë..

**b) Rezultatet që prisni**

Bashkia Shkodër synon të përforcojë infrastrukturën dhe mbështetjen për banorët e zonave rurale.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë) | Ngakjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Oper ative | Trans ferta | Kapital e |
| A.1 | Furnizim me karburant ne funksion te emergjencave civile | **1,000** | | | 1,000 | | |
| **Shuma** | | **1,000** | | | **1,000** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë) | Ngakjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sig uri me | Oper ative | Trans f erta | Kapi tale |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Furnizim me karburant ne funksion te emergjencave civile | **1,000** | | | 1,000 | | |
| **Shuma** | | **1,000** | | | **1,000** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mijë lekë) | Ngakjo: | | | | |
| | | | Paga | Sig uri me | Oper ative | Trans f erta | Kapi tale |
| A.1 | Furnizim me karburant ne funksion te emergjencave civile | **1,000** | | | 1,000 | | |
| **Shuma** | | **1,000** | | | **1,000** | | |
| **f) Periudha e zbatimit** 2026 – 2028 | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Personeli i Drejtorisë së Emergjencave Civile ne Bashki **Institucioni likuidues**: Bashkia Shkodër | | | | | |

| Nr.11 | **P.AB141.Q2.O1.A5**<br>Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie | **Programi AB141:** Siguria publike dhe Mbrojtja civile |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Baza ligjore:139/2015 "Për vetë qeverisjen vendore", Neni 29, LIGJ Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM nr 965 date 02.12.2015 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e Emergjencave Civile dhe krizave" si dhe vecanerisht VKM 329, date 16.05.2012

- Është bërë vlerësimi i dëmeve nga specialistët e ngarkuar me urdhër të brendshëm dhe hartimi i preventivave për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore
- Është plotësuar dokumentacioni për dhënien e ndihmës se menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie

Për të gjitha rastet e zjarrit në banesa është kryer verifikimi e hartuar dokumentacioni, është dhënë ndihma e menjëhershme si dhe është bërë vlerësimi i dëmeve ekonomike dhe dhënia e vlerave financiare(dëm ndërtimor në banesa + orendi)

**ii. Synimi i projektit**

Duke iu referuar

- Shkresës së Ministrisë së Brendshme nr. 7007, datë 20.10.2016 "Për planifikimin e fondeve për mbrojtjen civile dhe për hartimin e dokumentacionit për familjet,banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësit e ndryshme "
- Ligjit nr. 45/2019 "Për Mrojtjen Civile" i përditësuar ,
- VKM 329 datë 16.05.2012 "Per kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimine dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerzore"
